



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 274, datë 28.12.2020

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË
ENERGJISË NË LIDHJE ME SHTIMIN E SHTOJCËS “E” NË RREGULLAT E
PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
MIRATUARA ME VENDIMIN E BORDIT NR. 193, DATË 24.11.2017**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “gj”, nenit 62, nenit 76, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/17 Prot, datë 24.12.2020, të Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 193, datë 24.11.2017, bordi i ERE miratoi “Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”.
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me shkresën nr. 23/157 Prot., datë 22.10.2019, ka ftuar ERE-n të nisë procedurën për amendimin e “Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”, duke përfshirë në këtë dokument edhe shtojcën “E” të përgatitur dhe propozuar nga Sekretariati.
- Ndryshimet e propozuara nga Sekretariati adresojnë trajtimin e problematikës së ngritur nga HEC “Ashta” për trajtimin e disbalancave. HEC “Ashta” ka parashtruar pretendimin se ka konstatuar devijime midis informacionit të një dite më parë dhe shkarkimit aktual të ujit realizuar nga HEC “Vau i Dejës” duke rezultuar kjo në krijimin e devijimeve të cilat shkaktohen nga pjesëmarrës të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe jo nga vetë subjekti HEC “Ashta”.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 21, datë 31.01.2020, vendosi: «Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës “E” në Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike të miratuara me vendimin e bordit nr. 193, datë 24.11.2017».
- Bordi i ERE me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Mbështetur në pikën 5 të vendimit të lartpërmendur, e cila parashikon detyrimin për raportim dhe dokumentim çdo muaj nga ana e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), në lidhje me ecurinë e zbatimit të tyre, OST sh.a. ka raportuar në mënyre periodike në ERE lidhur me ecurinë e zbatimit të fazës Dry Run (pa efekte financiare) të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- Raportet janë përcjellë në ERE nëpërmjet shkresave me nr. 5263 Prot., datë 03.09.2020 dhe nr. 6006 Prot., datë 09.10.2020, por edhe në adresën zyrtare të e-mailit të ERE, erealb@ere.gov.al, ndërkohë që me shkresën nr. 7186 Prot., datë 27.11.2020 në ERE është përcjellë Raporti i Vlerësimit.
- Nga informacioni i evidentuar në raportet e dërguara nga OST sh.a., rezultoi se përgjatë periudhës DRY Run të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nuk u konstatua asnjë raportim problematik lidhur me sa parashtruar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për trajtimin e problemeve të ngritura nga HEC “Ashta” që lidhen me disbalancat.
- Si dhe lartpërmendur, bordi i ERE vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike përmes vendimit nr. 106, datë 02.07.2020, hyrja në fuqi me efekte financiare e të cilave shfuqizon “Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.193, datë 24.11.2017, parashikimi ky i përcaktuar në pikën 4, të vendimit të bordit të ERE nr. 106/2020.

Sa parashtruar më sipër, shtimi i shtojcës “E”, propozuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017, me shfuqizimin e tyre, si parashikuar në vendimin e bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020, do të bënte që ky ndryshim të ishte pa efekte juridike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të mos miratojë kërkesën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës “E” në Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI